



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 3503
Nr. 2222/3503 Akti
Vendimi

NR. VENDIMI 2872
Nr. 2872

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtar **Besnik HOXHA**

Me pjesmarjen e prokurorit **Elio Mazreku**, asistuar nga sekretare **Florinda Nushi**, sot më date 01-11-2021, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore publike çështjen penale në ngarkim:

TE PANDEHURVE:

Eris Tafa, i biri Skënder-it dhe Liljanes, i datelindjes 22.04.1991, lindur dhe banues rruga "Dalip Zavalani" pall.7, shk.1 Tirane, me arsim të mesëm, i dënuar, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, me masë sigurimi "arrest shtëpie", gjykuar në mungesë të vullnetshme. Përfaqësuar në gjykim nga Av.Elton Hyseni, sipas deklaratës në dosje.

A K U Z U A R :

Për veprën penale të "**Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve**", parashikuar nga Neni 283/1 i Kodit Penal.

Erion Dibra, identifikuar me ID-Nr.K00413046C, i biri Arben-it dhe Servetes, i datelindjes 13.04.2000, lindur dhe banues rruga "Ali Demi" Nd.2 Tirane, me arsim të mesëm, i padënuar, me shtetesi dhe kombesi shqiptare. Mbrojtur në gjykim nga Av.Ismail Aga me Nr.9505 license, sipas prokurës me Nr.3338 rep. 969 kol. Dt.30.07.2021.

OBJEKTI :

Pushimin e akuzës për veprën penale të "**Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve**", parashikuar nga Neni 283/1 i Kodit Penal

Gjykata pasi pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar, administroi provat, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të Prokurorit, i cili kërkoi: **1.**Deklarimin fajtor të pandehurit **Eris Tafa**, për veprën penale të "**Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve**", parashikuar nga Neni 283/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me **6 (gjashtë) vjet burgim**, aplikimin e nenit 406 te K.Pr.Penale ; **2.**Pushimin

e akuzës ndat personit nën hetim Erion Dibra, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 I K.Penal;

Av.E.Hyseni-kërkoj dënimin nën minimum të pandehurit Eris Tafa , jemi mjaft të penduar për veprën e kryer;

Av.I.Aga- jemi dakort me kërkesën për pushimin e akuzës ndaj shtetasit Erion Dibra; Shtetasi E.Dibra dakort me avokatin;

si deklaroi të mbyllyr shqyrtimin gjyqësor dhe bisedoi ceshtjen në tëresi

VEREN :

Se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar Gjykatës me kërkesën Nr.2222 Akti, datë 06.08.2021 regjistrimi me objekt : Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal Nr.8830/2021 në ngarkim të pandehurit Eris Tafa, akuzuar për veprën penale të “*Prodhim, shitje të lëndëve narkotike*“, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, si dhe pushimin e akuzës për shtetasin Erion Dibra, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 I K.Penal duke i bashkalidhur kërkesës edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli për gjykim.

Me vendimin Nr.2222 akti, dt. 06.08.2021, të gjyqtarit tëseances paraprake është vendosur që çështja të dërgohet për gjykim.

Në seancën paraprake i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar në bazë të neneve 332/c/3 dhe 403 te K.Pr.Penale.

Gjykata pasi degjoi parashtrimin e prokurorit, e pranoi kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar në baze të nenit 405/6 të K.Pr.Penale, pasi çmon se çështja zgjidhet në gjëndjen që janë aktet dhe zhvilloi gjykimin sipas kërkesave të këtij neni, pra duke u bazuar në gjëndjen që janë aktet.

Megjithate ka rezultuar plotesisht e provuar se :

Më date 10.12.2020, me qëllim verifikimin e këtij informacioni, punonjës policie kanë konstatuar se shtetasi Erion Dibra ndodhej në rrugën "Petro Nini Luarasi" është futur në një rrugicë lagjeje dhe më pas rreth orës 12:00 është takuar me të pandehurin Eris Tafën në sheshin e pallatit nr.7. Nisur nga fakti që shikonin rreth e rrotull dhe bënin lëvizje të dyshimta, policia ka ndërhyrë dhe i ka kapur në flagrancë. Të dy janë orvatur të mos kapen dhe të largohen, ndonëse policët u janë prezantuar si të tillë. Sipas policisë, të dy ata kanë fyer dhe bënin qëndresë ndaj policëve që, pas disa minutash, kanë arritur t'i prangosnin dhe t'i nënshtrohen kontrollit fizik.

Kontrolli fizik tregoi që personi nën hetim Erion Dibra kishte me vete në brendësi të tutave dy mbështjellëse alumini brenda të cilave u gjetën lëndë që nga cilësitë fizike duken si Cannabis Sativa në formë bari dhe në formë të një boçeje bime që është e tharë.

Sakaq, ndodhur në këto kushte i është kërkuar Eris Tafës që të bëhej një kontroll në banesën e tij që ishte aty afër vendit ku u kap, por ai nuk e ka pranuar këtë gjë. Në kohën që janë afruar në shkallët e pallatit nr. 7, policët janë përballur me shtetasen Liljana Tafa, e cila u njoftua prej tyre për qëllimin e ardhjes, ajo ka pranuar që të ushtrohej kontrolli në banesën e saj dhe të të birit.

Në kontrollin e banesës menjëherë sapo janë futur në kuzhinë, mbi një tryezë druri, policët kanë gjetur një qese plastmasi ngjyrë të bardhë, në të cilën ishin katër mbështjellëse alumini brenda të cilave kishte lëndë që për nga veçoritë fizike, ishte Cannabis Sativa, ngjitur me të ishte dhe një qese

tjetër plasmasi, ngjyrë e zezë, në të cilën kishte lëndë që për nga veçoritë fizike ishte Cannabis Sativa, por në trajtë boçesh të thara. Kontrolli ka vijuar në dhomën e gjumit të Eris Tafës ku, në një hapësirë në mes të dollapit të teshave është gjetur një kartëpecetë në të cilën kishte pluhur të bardhë që për nga veçoritë fizike, u dyshua se ishte kokainë. Në kontrollin e banesës u gjet dhe një sasi ë hollash (50.000 lekë) që u sekuestruan si provë materiale.

Lënda e dyshuar hashash që u gjet në trup shtetasit Erion Dibra tregoi për 6 gramë, e cila u administrua në qesen e provave nr.B20001955.

Lënda e dyshuar hashash që u gjet në banesë të pandehurit Eris Tafa u peshua dhe doli që ishte 97.2 gramë që u administrua në qesen e provave me nr .B20001958.

Lënda e dyshuar kokainë që u gjet në banesë Eris Tafës u peshua dhe doli që ishte në masën 3.0 gr, që u administrua në qesen e provave me nr.B20001957.

Për të gjitha sasi të sekuestruara të lëndëve të dyshuara u vendos ekspertimi kimik. Po ashtu, u morën për ekspertim dhe mostra urine nga të dyshuarit Erion Dibra dhe Eris Tafa që janë dërguar për ekspertime toksikologjike.

Si gjatë kapjes në flagrancë dhe më pas, të dy të dyshuarit kanë pretenduar që sasi të gjetura i kishin për përdorim vetjak dhe kanë përjashtuar që të kenë bashkëpunuar me njëri-tjetrin në çështjen e mbajtjes apo të shpërndarjes së drogave.

Nga akti ekspertimit kimik nr. 2498, datë 17.03.2020 ka rezultuar se: *“...Analizat GC/MS tregon se lënda narkotike që ju sekuestrua shtetasit Eris Tafa është cannabis sativa L, me peshë 81 gr. pa ambalazh. Ndërsa lënda ngjyrë e bardhë nuk ishte lëndë narkotike ose psikotrope. Kjo sasi prej 81 gr. nuk konsiderohet sasi e vogël për përdorim vetjak njëpërsorimësh apo dozë ditore.*

Lënda narkotike që u sekuestrua shtetasit Erion Dibra ishte cannabis sativa L, me peshë 3 gr pa ambalazh. Kjo sasi prej 3 gr. është dozë e vogël për përdorim vetjak.

Nga akti ekspertimit toksikologjik ligjor nr. 2736, datë 24.12.2020 ka rezultuar se: *“...Në mostrën e urinës së shtetasit Eris Tafa, u zbulua prania e produkteve të bimës cannabis sativa L dhe nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës në organizmin e njeriut”.*

Nga akti ekspertimit toksikologjik ligjor nr. 2721, datë 24.12.2020 ka rezultuar se: *“...Në mostrën e urinës së shtetasit Erion Dibra, u zbulua prania e produkteve të kanabinoidike të metabolizmit të bimës cannabis sativa L në organizmin e njeriut”.*

I pandehuri Eris Tafa shpjegon që lënda narkotike që u gjet në banesë e kishte hashash për përdorim vetjak sepse është përdorues prej 16 vjetësh, kurse lënda pluhur i bardhë nuk ishte kokainë, por sodë buke që e përdorte për shqetsimet që kishte në stomak. Sa i përket sjelljes që ka shfaqur para punonjësve të policisë pretendon që ato çaste i është krijuar një gjendje e sikletshme dhe nuk ka ditur si ka reaguar por, nuk ka pasur qëllim për të mos iu bindur urdhrave të policëve.

Shtetasi Erion Dibra pretendon që cannabisin që u gjet në kontrollin fizik e kishte për përdorim vetjak sepse ka tre-katër vjet që e përdor këtë lëndë.

Me veprimet e tij të kundraligjshme i pandehuri Eris Tafa me anë të mbajtjes

së substancave narkotike dhe psikotrope , ka konsumuar plotësisht kështu elementet e veprës penale të “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” . I pandehuri Eris Tafa ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura në bazë të ligjit për narkotikët për të siguruar rendin dhe qetësinë publike, jetën dhe shëndetin e personit , rregullat për shitjen, dhënien apo marrjen dhe mbajtjen në cdo mënyrë të substancave narkotike dhe psikotrope , përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla si dhe farërave të bimëve narkotike , të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale .

Akuza në ngarkim të pandehurit Eris Tafa është provuar si gjate hetimeve paraprake ashtu edhe në séance gjyqesore me administrimin e proces-verbalit të sekuestrimit të proves materiale, proces-verbali i arrestimit në flagrance dt.10.12.2020, akti ekspertimit kimik Nr.2498 dt.17.03.2020, akti ekspertimit toksikologjik nr.2736 dt.24.12.2020, Nr.2721 dt.24.12.2020 si dhe ne teresi aktet të ndodhura në fashikullin e procedimit penal Nr.8830 të vitit 2020, te cilat si u morën për shqyrtim u administruan në dosje dhe që në referim te **vendimit unifikues te Gjykates se Larte, nr. 2, date 29.01.2003, duke zbatuar gjykimin e shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet ne dosje gjyqesore.**

Për sa me sipër gjykata cmon se i pandehuri ka konsumuar plotësisht elementet e vepres penale, per te cilen ai akuzohet. Kështu si subjekt i vepres penale është i pandehuri Eris Tafa. Ai është madhor dhe ka mbushur moshën për përgjegjesi penale për veprën e kryer.

Gjate hetimit si dhe gjatë këtij gjykimi, asnjë dyshim nuk është shfaqur, ai është i përgjegjshëm për te kuptuar se po shkelte ligjin penal shqiptar, duke mbajtur lëndë narkotike.

Nga pikepamja e anës subjektive, i pandehuri ka vepruar me dashje të drejtpërdrejt, me qëllim mbajtjen e lëndes narkotike.

Objekti i veprës penale që ka kryer i pandehuri Eris Tafa jane marrëdhëniet juridike të vecanta të vendosura ne ligjin penal, me qellim per te siguruar jeten dhe shëndetin e njerëzve, e cila gëzon një mbrojtje të vecante nga legjislacioni ynë penal . Në rastin konkret objekt i këtij gjykimi, Gjykata krahas vështrimit të përgjithshëm dhe teorik që parashikohet për këtë veprë penale, mban në konsiderate dhe cmon edhe subjektin e kësaj vepre penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin, Gjykata ka detyrimin ligjor të marre në konsiderate rrezikshmerine shoqërore të veprës penale e reflektuar në rëndesine e padiskutueshme të marrëdhënieve juridike që prek, menyren dhe formen e kryerjes së veprës penale, llojin dhe sasinë e lëndës narkotike të sekuestruar. **Gjykata bazuar në nenet 47, 48, 49 të K.Penal** merr parasysh, shkallen dhe formën e fajit të të pandehurve në kryerjen e vepres penale (dashje direkte), rrezikshmërinë shoqërore të pandehurve, qëndrimin pohues e pendues të të pandehurve për veprën penale te kryer, gjendjen e tyre familjare .

Ne nje vleresim të hollesishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga të pandehurit, **Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me burgim për të pandehurin Eris Tafa i kërkuar nga organi i akuzes është ligjërisht i bazuar në dispozitën përkatëse penale, e masa e dënimit e kërkuar për t'u caktuar ndaj te**

pandehurit nga organi i akuzës është në raport të drejtë me vlerësimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale e ne vecanti , qëndrimin pohues e bashkëpunues te tyre me organet proceduese dhe rrethanat lehtësuese të pranishme në këtë rast të cituara më sipër.

Megjithate në llojin dhe masën e dënimit ndaj këtij të pandehuri, Gjykata mban parasysh sic u spjegua dhe me lart, rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të .

Ndërsa për personin në hetim Erion Dibra, akuza ndaj tij për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal duhet të pushohet, sepse plotësohen kushtet e kërkuara nga ligji për përjashtimin nga përgjegjësia penale për mbajtje të lëndës narkotike, doza të vogla dhe për përdorim vetjak.

PER KETO ARSYE:

Mbeshtetur ne nenet 384 e 390 te Kodit Pr. Penale Gjykata

V E N D O S I:

1. Deklarimin fajtor të pandehurit **Eris Tafa**, për veprën penale "Prodhim, shitje të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal dhe në baze të kësaj dispozite dënimin e tij me **6 (gjashte) vjet burgim.**

- Në aplikim të nenit 406/1 te K.Pr.Penale masës së mësipërme i zbritet 1/3 e saj dhe përfundimisht i pandehuri **Eris Tafa** denohet me **4 (kater) vjet burgim.**

- Vuajtja e dënimit për të pandehurin fillon nga data 10.12.2020 dita e arrestit në flagrancë, duke urdhëruar që kjo vuajtje të kryhet në një nga Burgjet e Sigurisë Zakonshme.

2. Pushimin e akuzës për veprën penale " Prodhim, shitje lëndëve narkotike" parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal ndaj shtetasit Erion Dibra, shuarjen e masës sigurimit " detyrim paraqitje në policinë gjyqësore" dhënë me vendimin Nr.2046 akti dt.13.12.2020.

-Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale asgjësimin e lëndës narkotike të sekuestruar si dhe shumën prej 50 000 leke sekuestruar në banesën e shtetasit Eris Tafa të kaloj në favor të shtetit.

- Shpenzimet gjyqësore dhe ato proceduriale i ngarkohen të pandehurve.
- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit te vendimit.

U shpall sot me Tiranë datë 01-11-2021.

S E K R E T A R E
G J Y Q T A R I

Florinda
Besnik HOXHA

NUSHI

SHPENZIMET GJYQËSORE

Taksa njoftimit 1x150 leke

Shpenzimet procedurale (prokurori) 46 000 leke